V E N D I M
Nr. 337, datë 15.7.1999

PËR KRIJIMIN E KOMISIONIT QEVERITAR PËR PROBLEMET UJORE ME VENDET FQINJ

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5 paragrafi 4 të ligjit nr. 8093, datë 21.3.1996 "Për rezervat ujore", me propozimin e Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Krijimin e Komisionit të përhershëm qeveritar për problemet ujore me vendet fqinj (Serbi, Mali i Zi, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, Greqi, Itali).

2. Komisioni të ketë në përbërje përfaqësues nga:

- Ministria e Punëve Publike dhe Transportit	kryetar
- Ministria e Punëve të Jashtme	anëtar
- Ministria e Rendit Publik	anëtar
- Ministria e Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë	anëtar
- Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit	anëtar
- Ministria e Pushtetit Lokal	anëtar
- Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit	anëtar
- Agjencia Kombëtare e Mjedisit	anëtar
- Akademia e Shkencave	anëtar
- Sekretariati teknik i këshillit kombëtar të ujit	anëtar

3. Titullarët e ministrive dhe të institucioneve të lartpërmendura të emërojnë përfaqësuesit e tyre në komision, brenda një muaji nga hyrja në fuqi e këtij vendimi. Komisioni të kryesohet nga Zëvendësministri i Punëve Publike dhe Transportit.

4. Komisioni të shqyrtojë dhe të hartojë projektet e marrëveshjeve, të statuteve dhe të rregulloreve me secilin vend fqinj, duke trajtuar në to të gjitha problemet e ekonomisë ujore, që ka Republika e Shqipërisë me këto vende.

5. Për probleme specifike që mund të lindin, komisioni krijon nënkomisione me ekspertë përkatës.

6. Veprimtaria e komisionit të mbështetet në legjislacionin shqiptar, si dhe në marrëveshjet e konventat ndërkombëtare, ku Republika e Shqipërisë është palë.

7. Fondi për shpenzimet e veprimtarisë së komisionit dhe të nënkomisioneve (pagesat, transporti, dietat etj.) përballohen nga Ministria e Punëve Publike dhe Transportit.

8. Për rastet e punimeve të nevojshme studimore, fondi përkatës miratohet nga Këshilli i Ministrave.

9. Ngarkohet Ministria e Punëve Publike dhe Transportit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko